



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 29

2001

Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8790 datë 10.5.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë".....	889
Ligj nr.8791 datë 10.5.2001	Për miratimin e "Marrëveshjes së Konkensionit të formës "ROT" të Minierës së Kromit Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit Klos dhe të Uzinës së Ferrokromit Burrel ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë së të Drejtës Italiane "DARFO" s.p.a.", si dhe dhënies së disa stimujve dhe garancive për konkensionarin e kësaj marrëveshjeje.....	893
Dekret nr.3000 datë 8.5.2001	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	903
Dekret nr.3023 datë 21.5.2001	Për lënie të shtetësisë shqiptare.....	904

L I G J
Nr. 8790, datë 10.5.2001

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7829, DATË 1.6.1994 "PËR
NOTERINË"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 2 ndryshon si vijon:

"Neni 2

Kushtet për t'u bërë noter

Profesionin e noterit mund ta ushtrojë çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, që plotëson këto kushte:

- a) Ka kryer arsimin e lartë juridik.
 - b) Ka mbushur moshën 25 vjeç.
 - c) Nuk është i dënuar për vepra penale të kryera me dashje dhe ka sjellje të mirë morale.
 - ç) Nuk është larguar nga funksioni i gjyqtarit, prokurorit, noterit, avokatit ose nga administrata publike, për shkelje disiplinore në punë, brenda një afati prej 3 vjetësh nga data e depozitimit të kërkesës.
 - d) Ka kryer stazhin njëvjeçar pranë një noteri.
 - dh) Ka dhënë provimin përkatës të kualifikimit dhe është vlerësuar me jo më pak se 80 për qind të pikëve. Në raste të veçanta, Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterëve mund të vendosin uljen e kufirit të vlerësimit minimal.
 - e) Ka punuar si asistent për një periudhë prej dy vjetësh pranë një noteri.
 - ë) Në çastin e emërimit noter, të mos ketë mbushur moshën 60 vjeç për burrat dhe 55 vjeç për gratë.
 - f) Është i pajisur me lejen përkatëse nga Ministri i Drejtësisë, pasi të jetë marrë pëlqimi i Këshillit të Dhomës Kombëtare të Noterëve.
 - g) Është anëtar i dhomës së noterëve të rrethit gjyqësor.
- Shtetasit që kanë punuar jo më pak se 3 vjet si gjyqtar, pedagogë të lëndëve juridike në Fakultetin e Drejtësisë, juristë në institucionet qendrore dhe avokatë përjashtohen nga kryerja e stazhit dhe punojnë si asistentë vetëm 6 muaj."

Neni 2

Pas nenit 2 shtohet neni 2/a me këtë përmbajtje:

“Neni 2/a
Stazhi

Kandidati për noter kryen stazhin pranë noterit të caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, i cili ka detyrë të përgatisë stazhierin si nga ana teorike, ashtu edhe nga ana praktike. Caktimi bëhet brenda një muaji nga paraqitja e kërkesës për kryerjen e stazhit, duke respektuar për aq sa është e mundur vullnetin e kandidatit dhe cilësinë e përgatitjes. Për të gjitha akreditimet, sipas kësaj dispozite, njoftohet Ministria e Drejtësisë."

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si vijon:

"Neni 3
Kualifikimi

Provimi i kualifikimit për profesionin e noterit jepet para komisionit të caktuar nga Ministri i Drejtësisë dhe nga Dhoma Kombëtare e Noterëve.

Komisioni pranon në provim personat që plotësojnë kushtet e parashikuara nga neni 2 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "dh", "e" dhe "ë" të këtij ligji.

Përbërja dhe funksionimi i komisionit caktohen nga Ministri i Drejtësisë dhe nga Dhoma Kombëtare e Noterëve."

Neni 4

Pas nenit 3 shtohet neni 3/a me këtë përmbajtje:

“Neni 3/a
Asistenca

Asistenti për noter punon pranë një noterit të caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, e cila në marrëveshje me noterin dhe asistentin cakton edhe masën e shpërblimit përkatës. Për caktimin respektohen rregullat e parashikuara në nenin 2/a të këtij ligji.

Në përfundim të periudhës së asistencës, asistenti pajiset me certifikatë të lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, pasi merret edhe vlerësimi me shkrim i noterit pranë të cilit asistenti ka punuar.

Asistenti i pajisur me certifikatë dhe që plotëson kushtet e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, regjistrohet në listën e noterëve që janë në pritje për emërim. Ai emërohet sipas radhës përkatëse dhe në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, në vendin e lirë që krijohet pranë dhomës së noterëve të rrethit gjyqësor, për të cilin ka kandiduar. Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterëve administrojnë listat e pritjes për vendet e lira për noter.

Fituesi pajiset me lejen përkatëse dhe anëtarësohet në dhomën e noterëve të rrethit përkatës gjyqësor. Brenda tri muajve nga anëtarësimi, ai duhet të fillojë veprimtarinë noteriale. Me kalimin e këtij afati, leja shfuqizohet dhe mund të rijepet vetëm me akt të motivuar të Ministrit të Drejtësisë."

Neni 5

Në nenin 6 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në fjalinë e parë, fjalët “edhe mendimin e” zëvendësohen me fjalët "pëlqimin e". Po aty shtohet fjalia si vijon: "Noteri transferohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Noterëve."

- Pas paragrafit të parë të nenit 6 shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

"Noteri, i cili kërkon të transferohet, regjistrohet në listën e noterëve që janë në pritje për

transferim. Ai transferohet sipas radhës në vendin e lirë që krijohet pranë dhomës së noterëve të rrethit gjyqësor, për të cilin ka bërë kërkesë. Për këtë fillimisht vendi i lirë për noter u ofrohet noterëve që kërkojnë të transferohen, sipas kësaj dispozite dhe më pas atyre që emërohen në përputhje me nenin 4 të këtij ligji, por në asnjë rast transferimet nuk mund të përbëjnë më shumë se 20 për qind të vendeve të lira për çdo dhomë noteriale. Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterëve administrojnë listat e pritjes për transferimin e noterëve. Brenda tri muajve nga anëtarësimi në dhomën e noterëve të rrethit përkatës gjyqësor, noteri duhet të fillojë veprimtarinë noteriale. Me kalimin e këtij afati, leja shfuqizohet dhe mund të rijepet vetëm me akt të motivuar të Ministrisë së Drejtësisë."

Shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje: "Kur nuk ushtron veprimtarinë e noterit për më shumë se një muaj pa lejen e Dhomës Kombëtare të Noterëve."

Neni 6

Në fund të nenit 8 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Para se të jepet masa disiplinore dëgjohet dhe noteri për të cilin kjo masë kërkohet."

Neni 7

Në nenin 11, pas fjalës "ndërgjegjës" shtohen fjalët "duke i qëndruar besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë".

Neni 8

Në nenin 12, pas fjalës së parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në një zyrë noteriale mund të punojnë vetëm një noter, stazhieri, asistenti dhe një sekretar. Dy ose më shumë noterë mund të punojnë bashkë në një zyrë noteriale vetëm me miratimin e Dhomës Kombëtare të Noterëve."

Neni 9

Në fund të nenit 15 shtohen fjalët "i njohur sipas ligjit."

Neni 10

Paragrafi i parë i nenit 16 ndryshohet si vijon:

"Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterëve mbajnë regjistrin për të gjithë noterët e Republikës. Ministri i Drejtësisë, duke u bazuar në numrin e popullsisë dhe në vëllimin e punës noteriale, pasi merr edhe pëlqimin e Dhomës Kombëtare të Noterëve, cakton për çdo dy vjet numrin e noterëve për çdo bashki dhe komunë afër saj. Noteri nuk mund të ushtrojë profesionin e tij jashtë territorit të njësisë vendore përkatëse ku është emëruar, me përjashtim të rasteve të veçanta kur një gjë e tillë miratohet nga dhoma e noterisë e rrethit gjyqësor përkatës."

Neni 11

Neni 17 ndryshohet si vijon:

"Noteri ka dy vula, njëra nga të cilat e thatë, të cilat përmbajnë: emrin, shkronjën e parë të atësisë, mbiemrin dhe vendin e ndodhjes së zyrës noteriale. Akti, që nuk përmban dy llojet e vulave, është i pavlefshëm."

Në Ministrinë e Drejtësisë depozitohen vulat, firma dhe kontrata e sigurimit për shkak të detyrës së noterit."

Neni 12

Në fund të paragrafit të parë të nenit 26 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"dhe zbatohet në mënyrë konkrete për çdo veprim noterial, duke u pasqyruar në regjistrin e noterit."

Neni 13

Pikat 1 dhe 4 të nenit 35 ndryshohen si vijon:

"1. Vendos anëtarësimin në dhomën e noterëve, të noterit të emëruar."

"4. Mbledh kuotat e anëtarëve dhe administron pasurinë e dhomës."

Neni 14

Në shkronjën "b" të nenit 49, në fund shtohen fjalët "e të koleksionit".

Neni 15

Në fund të paragrafit të parë të nenit 54, pas fjalës "gjqësor" shtohet fjala "detyrimi".

Neni 16

Në nenin 65, pas fjalëve "nga noteri" shtohen fjalët "sipas ligjit".

Neni 17

Në nenin 71, pas fjalës "evidentimit" shtohet fjala "administrimin".

Neni 18

Në të gjitha dispozitat e këtij ligji, fjala "rreth" zëvendësohet "rreth gjyqësor".

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3024 datë, 24.5.2001, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

L I G J

Nr.8791, datë 10.5.2001

**PËR MIRATIMIN E "MARRËVESHJES SË KONCENSIONIT TË FORMËS "ROT" TË
MINIERËS SË KROMIT BULQIZË, TË FABRIKËS SË PASURIMIT BULQIZË, TË
IMPIANTIT TË SELEKSIONIMIT KLOS DHE TË UZINËS SË FERROKROMIT BURREL
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT DHE
SHOQËRISË SË TË DREJTËS ITALIANE "DARFO" S.P.A.", SI DHE DHËNIES SË DISA
STIMUJVE DHE GARANCIVE PËR KONCENSIONARIN E KËSAJ MARRËVESHJEJE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet “Marrëveshja e koncensionit e formës “ROT” të Minierës së Kromit Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit Klos dhe të Uzinës së Ferrokromit Burrel ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë së të Drejtës Italiane “Darfo” s.p.a.”.

Lista e objekteve që jepen në koncension me këtë marrëveshje, i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Shoqëria koncensionare (tregtare) e themeluar prej palës koncensionare përjashtohet nga detyrimet e pagesës së taksave doganore dhe TVSH-së për makineritë, linjat, pajisjet e materialet e tjera që do të përdoren për investime për periudhën e investimit prej 8 vjetësh.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Koncensionit, Këshilli i Ministrave të trajtojë detyrimet ndaj shtetit, ndaj sigurimeve shoqërore dhe të tretëve që ka shoqëria tregtare “Albkrom” sh.a. Tiranë, për objektet që jepen në koncension.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Koncensionit, punonjësit që do të shkurtohen si rezultat i zbatimit të Marrëveshjes, të trajtohen në mbështetje të ligjit nr.8565, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albkrom””, sipas kriterëve që do të përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3028, datë 24.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

MARRËVESHJE KONCENSIONI

E lidhur midis:

Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, më poshtë e quajtur Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) i përfaqësuar nga zoti Viktor Doda, me detyrë Zv/ministër i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, i pajisur me autorizimin nr.2636 datë 23.3.2001, të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

dhe

Shoqërisë aksionere të së drejtës italiane të emërtuar “DARFO” spa, me seli në Darfo (Brescia), Italia Via A,Bonara no.12, më poshtë referuar si “Koncensionari” i përfaqësuar për negocimin dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Koncensionit nga Alessandro Zecca, në bazë të prokurës lëshuar më datën 27.3.2001 nga Ganfraco Banzato, në cilësinë e Presidentit të shoqërisë “Darfo” spa, që i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje Koncensionit.

Meqenëse ekzistojnë këto kushte paraprake:

Në kuadrin e zhvillimit të ekonomisë së vendit, Qeveria Shqiptare i ka dhënë një rol prioritar zhvillimit të industrisë minerare në përgjithësi;

Koncensionari është i interesuar të investojë në industrinë minerare për rehabilitimit dhe vënien në funksionim të plotë të Minierës së kromit Bulqizë, Fabrikës së Pasurimit të Kromit Bulqizë, Impiantit të Seleksionimit të Kromit Klos dhe Uzinës së ferrokromit Burrel në afatet dhe kushtet e përfshira në propozimin e paraqitur dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë “Projekti”)

Palët kanë rënë dakord dhe marrin përsipër të bashkëpunojnë plotësisht me qëllim realizimin e plotë të Projektit;

Neni 3 pika 9 e ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë“ (ndryshuar me akte të tjera ligjore) më poshtë referuar si “Ligji për koncensionet” lejon, me miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave, dhënien e koncensionit, negocimet e nënshkrimit e kontratave të shfrytëzimit, administrimit dhe rehabilitimit;

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 7 të ligjit Për Koncensionet ka shqyrtuar dhe ka miratuar propozimin e paraqitur nga “DARFO” spa VKM nr.82 datë 26.2.2001 duke i dhënë shoqërisë “DARFO” spa një koncension ROT (rehabilitim, shfrytëzimin, transferimin) për Minierën e kromit Bulqizë, Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë, Impiantin e seleksionimit Klos dhe Uzinën e Ferrokromit Bulqizë.

Këshilli i Ministrave i ka besuar Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit negocimin dhe nënshkrimit e kësaj Marrëveshjeje Koncensionit.

Palët kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Për zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

Marrëveshje: Ky dokument dhe anekset e tij;

Koncensionari: Shoqëria aksionere e së drejtës italiane e emërtuar “Darfo” spa me seli në Darfo (Brescia), Itali, Via A.Bonara nr.12, e përfaqësuar ligjërisht për negocimin dhe nënshkrimit e kësaj Marrëveshjeje, nga Alessandro Zecca në bazë të prokurës së lëshuar më datë 27.3.2001 nga z.Gianfranco Banzato, në cilësinë e Presidentit të shoqërisë “Darfo” spa.

Kontratat: Të gjitha kontratat e përfunduara për të siguruar shërbimet, pajisjet dhe gjithçka tjetër të nevojshme për realizimin e Projektit.

Forcë madhore: Në kuptim të kësaj kontrate, forcë madhore do të konsiderohen katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet dhe lufta;

Sipërmarrës: Të gjithë nënkontraktorët dhe furnizuesit për zbatimin, ndërtimin, furnizimin e bazës materiale dhe të pajisjeve teknologjike të nevojshme për Projektin;

Ndryshim i ligjit: Do të thotë çdo akt ligjor i miratuar nga organet kompetente të Republikës së Shqipërisë që ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje Koncensionit;

Objektet e marrëveshjes ROT: Miniera e Kromit Bulqizë, Fabrika e Pasurimit Bulqizë, Impianti i Seleksionit Klos dhe Uzina e Ferrokromit Burrel, Aneksi 1.

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA); Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit e Republikës së Shqipërisë;

Palët: Tregon OSHA-në dhe Koncensionarin;

Lejet: Lejet, licencat dhe autorizimet që mund të kërkohen për zbatimin e plotë të Projektit.

Periudha e Koncensionit: është 30 vjet që nga momenti i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Koncensionit

Projekt: Projekti i paraqitur në anekset 2 dhe 3, që ka për qëllim rehabilitimin, modernizimin, financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e Objektivit të Koncensionit;

Shoqëria Koncensionare: Shoqëria tregtare e të drejtës shqiptare e krijuar nga Koncensionari, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje ka për objekt të legjitimijë dhënien në koncension të Minierës së Kromit Bulqizë, Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, Impiantit të Seleksionit Klos dhe Uzinën e Ferrokromit Burrel, Aneksi 1, që OSHA-ja i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave ia beson Konkensionarit për të realizuar rehabilitimin, financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e këtij Objekti.

Neni 3
Kriteret specifike të punimeve

3.1 Kriteret specifike të punimeve do të jenë si më poshtë:

A. Në Minierën e Kromit Bulqizë

Faza e parë

1. Punime në sipërfaqe të minierës 150 000 USD.

2. Kompletimi dhe përfundimi i nënstacionit elektrik të nivelit XIV, kryerja e punimeve në dishenterinë nga niveli i XIV-XVI dhe punimeve nëntokësore për stacionin e pompimit dhe ujëmbledhësin, gjithsej 220 000 USD.

3. Rehabilitimi i sistemit të shfrytëzimit 120 000 USD.

4. Rehabilitimi i sistemit të pompimit 130 000 USD.

5. Rehabilitimi i impiantit të seleksionimit me dorë pranë galeri në nr.41 dhe rehabilitimi i sistemit elektrik të minierës 130 000 USD.

6. Rehabilitimi i transportit vertikal 170 000 USD.

7. Rehabilitimi i transportit nëntokësor 220 000 USD.

8. Montime nëntokësore në punimet minerare 60 000 USD.

9. Punimet kapitale të hapjes së minierës në thellësi 1.5 milion USD.

Në këtë fazë do të investohen 2.7 milionë USD, që do të realizohen për një periudhë prej 3 vjetësh.

Faza e dytë

1. Përfundimi i punimeve në traverbankun Klos-Bulqizë.

2. Përfundimi i punimeve kapitale të hapjes së minierës në thellësi deri në nivelin e XX sipas projektit të miratuar nga OSHA-ja.

Në fazën e dytë vlera e investimet do të jetë 7.3 milionë USD që do të realizohet për një periudhë 5 vjeçare.

Investimi total për këtë minierë, duke përfshirë të dy fazat, do të jetë 10 milion USD, për një periudhë 8 -vjeçare.

Në përfundim të investimeve të parashikuara në të dy fazat, prodhimi i mineralit të kromit nga Miniera, Bulqizës është llogaritur të jetë rreth 80 000 ton në vit mineral kromi me përmbajtje rreth 39% Cr₂O₃.

B. Në Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë

Në këtë fabrikë është parashikuar të investohen gjithsej 0.5 milion USD për një periudhë 3-vjeçare, të ndara sipas objekteve si më poshtë:

1. Remonti i repartit të thërmimit dhe zëvendësimi i pajisjeve të amortizuara.

2. Remonti i plotë i pajisjeve të repartit të bluarjes dhe kompletimi i skemës teknologjike.

3. Remonti i plotë i repartit të gravitacionit dhe zëvendësimi i pajisjeve të konsumuara.

4. Riparimi i plotë dhe rivënia në punë e repartit të çujëzimit.

5. Riparimi i laboratorit fiziko-kimik, kaldajës dhe ofiqinës mekanike.

Në përfundim të këtyre investimeve kapaciteti përpunues i Fabrikës së Pasurimit Bulqizë do të jetë 240 000 ton në vit.

Në përfundim të këtyre investimeve kapaciteti përpunues i Fabrikës së pasurimit Bulqizë do të jetë 240 000 ton në vit.

C. Në Impiantin e Seleksionimit Klos

Në këtë impiant është parashikuar të investohen gjithsej 100 000 USD për një periudhë prej 3 vjetësh në objektet si më poshtë:

1. Remontin kapital dhe përgatitjen për rifillimin e prodhimit të Impiantit të Klosit.
2. Riparimin e godinave dhe infrastrukturës në përgjithësi.

Të gjitha teknologjitë që do të aplikohen duhet të garantojnë mbrojtjen e mjedisit.

D. Në Uzinën e Ferrokromit Burrel

Për rehabilitimin dhe rikonstruksionin e kësaj uzine është parashikuar të investohen gjithsej rreth 4 milion USD të ndara në dy fazash më poshtë:

Në fazën e parë prej 3 vjetësh, nga data e fillimit të kontratës është parashikuar të realizohen rreth 1.2 milionë USD investime si më poshtë:

1. Riparim dhe mirëmbajtje e 2 furrave ekzistuese 9 MVA.
2. Instalimi i impiantit të thërmimit të FeCr.
3. Kompletimi i laboratorit kimik.
4. Rikonstruksioni i impiantit të përgatitjes së lëndës së parë.
5. Investime për rritjen e sigurisë në punë të punonjësve.
6. Riparimi dhe kompletimi i sistemit higjeno-sanitar për punonjësit.

Në fund të fazës së parë të investimeve prodhimi i FeCr do të jetë 24 000 ton FeCr në vit.

Në fazën e dytë prej 5 vjetësh është parashikuar të realizohen rreth 2.8 milionë USD, si më poshtë:

1. Rikonstruksioni total i dy furrave ekzistuese me fuqi 12 MVA.
2. Instalimi i pajisjeve komplete të taposjes së metalit dhe skorjes.
3. Instalimi i një sistemi komplet, Baltimor, të qarkullimit të ujit.
4. Sistemi i përgatitjes së lëndës së parë për të tre furrat.
5. Rikonstruksioni i sistemit të ngarkimit të furrave dhe derdhjes së FeCr.

6. Investime për pjesën ndërtimore të pajisjeve dhe sistemimeve që do të instalohen si dhe zyrat e administratës.

Në përfundim të fazës së dytë të investimeve prodhimi i FeCr do të jetë 30 000 – 42 000 ton në vit.

Për investime të mëtejshme Konkensionari do t'i paraqesë OSHA-së brenda vitit të parë të fazës së dytë, një studim të plotë fizibiliteti mbi bazën e të cilit palët do të vendosin për instalimin e furrës së tretë, ose zgjidhje të tjera teknike.

E. Investime për mbrojtjen e ambientit

Të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen nga Konkensionari, nga momenti i marrjes në konkension, do të jenë objekte nën kujesin e vazhdueshëm të mbrojtjes së ambientit në vendet ku ai ushtron aktivitetin e tij, sipas normave të Komunitetit European.

Synimi kryesorë i Shoqërisë Konkensionare do të jetë aplikimi i teknologjisë “Darfo” për të garantuar një fuqizim të procesit teknologjik në respektim të mbrojtjes së mjedisit.

Investimi total i parashikuar për mbrojtjen e mjedisit për të gjithë periudhën e projektit të investimeve prej 8 vitesh, do të jetë 6 milionë USD të ndara:

1. Në Minierën e Bulqizës 1.5 milionë USD.
2. Në Fabrikën Pasurimit Bulqizë dhe Dambë 1.3 milionë USD.
3. Në Uzinën e Ferrokromit Burrel 3.2 milion USD.

Grafiku dhe objektet ku do të kryhen këto investime do të përcaktohen sipas një projekti që Konkensionari do t'ja paraqesë për miratim OSHA-së brenda vitit të dytë të investimeve.

Investimet totale për të gjitha objektet e konkensionit do të jenë 20.6 milionë USD.

3.2 Mos respektimi i punimeve sipas projektit në afatet e përcaktuara në kohë sipas nenit 3.1, në çdo fazë, e ngarkon konkensionarin që të paguajë një penalitet prej 0.05% në ditë të vlerës së investimit të përealizuar pas çdo 2 muaj vonesë.

Neni 4

Koha e fillimit të punimeve

4.1 Koncesionari do të fillojë punimet, sipas specifikimeve të përcaktuara në nenin 3, brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

4.2 Në rastet e krizave të rënda në tregun e ferrokromit, kur çmimi i ferrokromit bie në mënyrë të ndjeshme, Koncesionari në marrëveshje me OSHA-në mund të mbajë provizorisht të bllokuar prodhimin në Uzinën e Burrelit, për periudhën e zgjatjes së krizës. Në këtë rast Koncesionari është i detyruar të marrë masat e domosdoshme për ruajtjen dhe konservimin e objekteve të uzinës.

Neni 5

Detyrimet e Koncesionarit

5.1 Koncesionari brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje do të paraqesë pranë OSHA-së të gjithë ndryshimet e duhura të dokumentacionit të Shoqërisë Koncesionare si dhe do të bëjë regjistrimet e nevojshme për t'ju nënshtruar të gjithë dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.

5.2 Koncesionari merr përsipër të kryejë gjithçka që nevojitet për realizimin e Objektivit të Marrëveshjes që i është besuar në Koncesionar, kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

5.3 Të respektojë të drejtën e OSHA-së për ruajtjen e pronësisë të mjeteve kryesore të dhëna në koncesion për sa kohë që ato nuk do të transferohen nga Koncesionari.

5.4 Të respektojë të drejtën e ndërhyrjes së OSHA-së deri në marrjen në dorë të projektit përkohësisht, në rastet kur konstatohen shkelje të rënda nga ana e Koncesionarit, që janë me pasoja për ecurinë e punës.

5.5 Në mënyrë të veçantë Koncesionari merr përsipër:

të realizojë Projektin, me mjetet e veta financiare, sipas specifikimeve të nenit 3;

të marrë masa me qëllim që çdo punim i besuar në sipërmarrje të jetë përmbushur në përputhje me afatet dhe me cilësitë e parashikuara në këtë Marrëveshjeje;

të ruajë dhe të administrojë Objektet e Marrëveshjes gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit, në përputhje me specifikimet e kësaj Marrëveshjeje;

të respektojë dhe të kërkojë që të respektohen të gjitha dispozitat ligjore në fushën e marrëdhënieve të punës, sigurimeve shoqërore dhe sigurimet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar;

të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë jetën dhe paprekshmërinë e punëtorëve dhe të tretëve, të shmangë dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e karakterit të përgjithshëm teknik, për të parandaluar çdo dëm dhe fatkeqësi në punë;

të lidhë kontrata sigurimi që të mbulojnë të gjitha risqet e paparashikueshme për një kohëzgjatje të njëjtë me Periudhën e Koncesionit;

Koncesionari detyrohet që me përfundimin e Periudhës së Koncesionit të transferojë OSHA-së të rehabilituar Objektet e marra në koncesion.

Koncesionari nuk mban përgjegjësi për gjendjen aktuale të mjedisit deri në datën e marrjes në dorëzim të objekteve të koncesionit.

Neni 6

Detyrimet e Organit Shtetëror të Autorizuar

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

a. të verë në dispozicion të Koncesionarit Objektet e Koncesionarit të përcaktuara në nenin 2, në gjendjen në të cilën ndodhet dhe është dokumentuar nga inventari që palët angazhohen të përpunohen brenda fillimit të punimeve të përcaktuara në nenin 4 më sipër.

b. Të ofrojë asistencën e nevojshme për të organizuar sigurimin fizik të Objekteve të Koncesionit nga Koncesionari në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

c. T'i sigurojë Koncesionarit nxjerrjen e autorizimeve, lejet e punimeve, lejet e ndërtimeve dhe ato të mbrojtjes së mjedisit, sipas kërkesave të bëra nga Koncesionari, me kush që kërkesat e bëra të jenë të përpiluara në formën që kërkon ligji, për fillimin e aktivitetit dhe më pas të asistojë Koncesionarin për nxjerrjen e dokumentacionit të mësipërm për vazhdimin e aktivitetit gjatë Periudhës së Koncesionit.

d. Të asistojë Koncesionarin për realizimin e Projektit pranë çdo organi e autoriteti shqiptar e t'i garantojë Koncesionarit dhe Shoqërisë koncesionare ekskluzivitetin për realizimin e Projektit, për objektet e dhëna në koncesion gjatë periudhës së koncesionit.

e. Të asistojë Koncesionarin në lidhjen e kontratave kolektive të punës.

f. Të marrë përsipër zgjidhjen e çdo problemi që lidhet me pretendimet e të tretëve, privat ose publik, për pronësi mbi tokën dhe objektet e dhëna në koncesion, si dhe pretendimet e të tretëve për borxhet që mund të kenë objektet e kësaj Marrëveshjeje gjatë ushtrimit të aktiviteteve të mëparshme.

Neni 7

Vlerësimi i investimit

7.1 Investimi total i Koncesionarit do të jetë sa është parashikuar nga Projekti sipas specifikimeve të nenit 3.

7.2 Ndryshime në Projekt mund të bëhen me pëlqimin e të dy palëve dhe vlera e pakësimit të investimit nuk do të jetë më shumë se 10% të vlerës, të specifikuar në nenin 3.

Neni 8

Periudha e Koncesionit

8.1 Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, OSHA-ja i beson Koncesionarit të shfrytëzojë në mënyrë efektive për 30 vjet objektet e përcaktuar në nenin 2 të Marrëveshjes.

8.2 Periudha prej 30 vjetësh fillon nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, siç është parashikuar nga neni 18.

8.3 Periudha e përcaktuar në nenin 8.1 mund të shkurtohet të zgjidhet Marrëveshja për njerën nga rastet e parashikuara në këtë marrëveshje ose mund të zgjatet në rastet kur verifikohet një ngjarje e forcës madhore .

Neni 9

Detyrim për Koncesionin

9.1 Koncesionari i paguan OSHA-së si detyrimin për koncesion për shpërblimin e punonjësve që shkurohen nga kalimi në koncesion i Objekteve të Koncesionit, në zbatim të nenit 6 pika 1 të ligjit nr.8562 datë 22.12.1999 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Albkrom", shumën 248 milion lekë për 2 (dy) vjet, të ndara në 8 (tetë) këste, si më poshtë:

a. 31 milion lekë, brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes.

b. 31 milion lekë, në datën 10 të muajit të parë të çdo tremujori, deri në plotësimin e shumës totale.

9.2 shuma e përcaktuar në pikën 9.1, do të derdhet në llogarinë që do të përcaktojë OSHA-ja e cila do t'i njoftohet me shkrim Koncesionarit.

9.3 Mospagimi nga ana e Koncesionarit të detyrimit për koncesionin në shumat dhe afatet e përcaktuara në pikën 9.1, e detyron Koncesionarin të paguajë penaltetin në vlerën 200 USD për çdo ditë vonesë.

Neni 10
Mbështetja për projektin

10.1 Me miratim nga Kuvendi të përjashtohet Shoqëria Koncensionare për periudhën e investimit, nga detyrimet e pagesës së taksave doganore dhe TVSH-në, për makineritë, linjat, pajisjet e materiale të tjera që do të përdoren për investime, sipas specifikimeve në projekt, me miratimin e OSHA-së.

10.2 OSHA-ja bëhet garant që TVSH-ja do të rimbursohet rregullisht, sikurse është parashikuar në ligjin nr.8714 datë 15.12.2000, neni 2, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së nga Koncensionari (Darfo Albania shpk).

Neni 11
Zgjidhja e Marrëveshjes së Koncesionit

11.1 OSHA-ja ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Marrëveshjes së Koncesionit për rastet kur konstaton shkelje të detyruara nga ana e Koncensionarit të përcaktuara në këtë Marrëveshje të cilat kompromentojnë grafikun e investimit, cilësinë e tyre dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes, përjashtimisht sa parashikohet në nenin 4.2.

11.2 Koncensionari ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Marrëveshjes së Koncesionit për rastet kur konstaton shkelje të detyrimeve nga ana e OSHA-së, të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

11.3 Kur nga ana e palëve verifikohen rastet e përmendura në pikat 11.1 dhe 11.2, ato menjëherë do t'ja bëjnë të njohura këto raste palës tjetër dhe do të presin për një periudhë 30 ditore përgjigjen me shkrim të saj me argumentet përkatës. Mbi bazën e këtyre përgjigjeve palët do të vendosin për të filluar ose jo procedurat për zgjidhjen e Marrëveshjes.

11.4 OSHA-ja ka të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Koncesioni në se Koncensionari brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje nuk paraqet për të realizuar detyrimet kontraktuale ose refuzon të marrë në dorëzim objektin e Koncesionit ose pjesë të tij.

Neni 12
Kontratrat

Koncensionari ka të drejtë që të përdorë nënkontraktorë për realizimin e Projektit.

Në të gjitha kontratat që do të lidhë Koncensionari me të tretët ai duhet të respektojë ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe parashikimet në këtë Marrëveshje.

Koncensionari do të jetë përgjegjës i vetëm kundrejt OSHA-së për zbatimin e përpiktë të Projektit, pavarësisht nga kontratat që do të lidhen me të tretët.

OSHA-ja nuk ka asnjë detyrim kundrejt të tretëve që lidhen me Koncensionarin dhe me këtë Marrëveshje.

Neni 13
Sigurimet

Koncensionari për të gjithë Periudhën e Koncesionit dhe me shpenzimet e veta do të sigurojë Objektet e kësaj marrëveshjeje që lidhen me Projektin në institucionet e sigurimit, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Koncensionari pajis OSHA-në me kopjet e dokumentacionit përkatës për sigurimet e bëra.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet ose dëmtohet për shkak të rreziqeve për të cilat është siguruar, çdëmtimet në para të marra nga Koncensionari për këtë qëllim, do të përdoren për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendje funksionale në parametrat e Projektit.

Neni 14

Riparimi dhe mirëmbajtja

Gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari do të kryejë me shpenzimet e veta të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e nevojshme, të zakonshme e të jashtëzakonshme, të objektit të përcaktuar në këtë Marrëveshje, së bashku me inventarin përkatës që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e tij, në përputhje me kushtet e përcaktuara ndërmjet Palëve.

Neni 15

Kontrolli dhe Inspektimet

OSHA-ja ruan të gjitha të drejtat kontrolluese mbi Koncesionarin të parashikuara në nenin 13 të “Ligjit për Koncesionin” nr.7973 datë 26.7.1995.

OSHA-ja nëpërmjet personave të autorizuar ushtron kontroll për verifikimin e ecurisë së punimeve në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit të Projektit të Koncesionit, të paktën dy herë në vit dhe për probleme të veçanta sa herë të jetë e nevojshme.

Koncesionari nuk mund të kufizojë në kontroll personat e autorizuar të OSHA-së. Ai duhet t’u japë atyre të gjitha sqarimet përkatëse.

Për të gjitha shkeljet e konstatuara nga OSHA-ja gjatë inspektimit në objekt, OSHA-ja do të njoftojë me shkrim koncesionarin, i cili do të marrë masa për riparimin e tyre dhe mospërsëritjen në të ardhmen, në afatet e përcaktuara me marrëveshje midis palëve.

Neni 16

Legjislacioni i zbatueshëm

Interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj.

Neni 17

Forca Madhore

Palët nuk mund të jenë përgjegjës në rast mospërbushjeje të detyrimeve të tyre të parashikuara nga kjo Marrëveshje si pasojë e verifikimit të njerës prej ngjarjeve të forcës madhore.

Në rastin kur një detyrim i parashikuar nga kjo Marrëveshje vonohet ose bëhet i pamundur nga një ngjarje e forcës madhore, Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim menjëherë Palët e tjera duke treguar motivet e pamundësisë ose vonesës dhe masat e marra për të evituar pasojat.

Gjatë zbatimit të Marrëveshjes, në rast se verifikohen ndodhi të forcës madhore, që sjellin vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të Palëve, ato nuk mund të jenë motiv për kërkesa reciproke për çdëmtim.

Periudha e ndërprerjes dhe shtyrja e afateve të parashikuara për përmbushjen e detyrimeve përkatëse, konfirmohet me një proces-verbal të nënshkruar nga Palët.

Periudha e Koncesionit do të zgjatet me një periudhë të barabartë me atë të kohëzgjatjes së ngjarjes së forcës madhore dhe për një periudhë kohe të mëtejshme të nevojshme për të eliminuar pasojat dhe për të rifilluar punimet.

Neni 18

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Koncesionit

Kjo Marrëveshje Koncesioni do të hyjë në fuqi kur të jetë firmosur nga palët dhe të jetë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjin “Për Koncesionet” nr.7973, datë 26.7.1995 (ndryshuar me akte të tjera ligjore).

Neni 19
Anekset

Anekset nr.1, 2 dhe 3 janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje.

Neni 20
Dispozita të Përgjithshme

Kjo Marrëveshje, së bashku me të gjithë dokumentet dhe anekset, hartohen në gjuhët shqip, italisht dhe anglisht (UK). Për çdo problem që mund të dalë në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si gjuhë reference do të jetë gjuha Angleze dhe varianti në gjuhën angleze do të konsiderohet ligjërishit i detyrueshëm.

Kjo Marrëveshje është hartuar dhe nënshkruar në 5 (pesë) kopje origjinale, 3 (tre) nga të cilat në dispozicion të OSHA-së dhe 2 (dy) në dispozicion të Koncensionarit.

Neni 21
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët marrim përsipër në parim të zgjidhin me mirëkuptim çdo tip mosmarrëveshjeje.

Asnjë problem ose mosmarrëveshje midis Palëve në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndërpresë zbatimin e detyrimeve të Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në rast se një gjë e tillë nuk është e mundur, çdo lloj mosmarrëveshje ose pretendim i lindur, apo i lidhur me këtë marrëveshje, ose shkëlja, zgjidhja apo pavlefshmëria e saj, do të shqyrtohet dhe të zgjidhet nëpërmjet arbitrimit sipas rregullave të arbitrimit UNICITRAL aktualisht në fuqi.

Arbitrazhi përbëhet prej tre arbitrash, dy prej të cilëve emërohen respektivisht prej Palëve dhe i treti në funksionin e kryetarit, i emëruar nga arbitrat, ose në rast se nuk arrihet në mirëkuptim për zgjedhjen e kryetarit, ai caktohet prej Kryetarit të Dhomës së Tregtisë së Parisit, brenda 30 ditësh prej bërjes së kërkesës nga Pala më e interesuar. Gjithsesi, përpara krijimit të Gjykatës së Arbitrave, secila nga Palët mund të kërkojë marrjen e masave të jashtëzakonshme për të siguruar objektin e padisë prej gjykatës kompetente. Këto masa do të konfirmohen prej gjykatës së arbitrave.

Arbitrazhi do të vendosë brenda 90 ditëve prej datës së pranimit të detyrës së arbitrit të trtë.

Vendi i zhvillimit të arbitrazhit do të jetë Parisi. Gjuha e arbitrimit do të jetë ajo angleze.

Neni 22
Bshkëpunimi midis OSHA-së dhe Koncensionarit

OSHA-ja dhe Koncensionari marrin përsipër reciprokisht të bashkëpunojnë njeri me tjetrin me qëllim që të garanohet zbatimi i çdo pjese të Projektit.

Me përjashtim të rastit kur Palët me shkrim kanë rënë dakord ndryshe e gjithë korrespondenca do t'u dërgohet me shkrim personave të poshtëshënuar, me anë të një letre të dorëzuar dorazi, ose me letër të regjistruar telegram ose faksimile.

Adresat dhe numrat e fakseve zyrtare që do të përcaktohet gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje janë:

Për OSHA-në:

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

Sheshi Skënderbej nr.2

Tirana, Albania

Për dijeni: Irakli Premti

Fax: + +355 4226 143

Për Koncensionarin:

Darfo Spa

Via A.Bonara, n.12
Darfo (Brescia), Italia
Për dijëni: Mario Appolonia
Fax: + +355 4230 489

Palët marrin përsipër të ruajnë karakterin konfidencial të gjithë informacionit teknik dhe tregtar që lidhet në një mënyrë apo në një tjetër me Marrëveshjen e Konkensionit. Ky nen do të qëndrojë detyrues në fuqi për të gjithë periudhën e konkensionit dhe për 2 vjet pas përfundimit të tij.

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet i vlefshëm në rast se nuk është pranuar me shkrim nga të dyja Palët.

Për OSHA-në

Për Konkensionarin

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit
Zv/Ministri

Darfo SPA
Drejtori i Përgjithshëm

Viktor Doda

Alessandro Zecca

D E K R E T
Nr.3000, datë 8.5.2001

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 24 dhe 19 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Fadil Temo Shabanaxhaviq
2. Violeta Ahmet Shabanaxhaviq
3. Drita Fadil Shabanaxhaviq
4. Ardian Fadil Shabanaxhaviq
5. Dritan Fadil Shabanaxhaviq
6. Ardita Fadil Shabanaxhaviq
7. Feride Hasan Hyseni
8. Përparim Tosun Hyseni
9. Fatmira Tefik Hyseni (Mujollari)
10. Mateja Përparim Hyseni
11. Austin Përparim Hyseni
12. Marika Kosta Bellovoda
13. Vaso Stevo Drinjak
14. Mlladen Stevo Drinjak
15. Frederik Kujtim Bulku
16. Isa Zenel (Zejnol) Bujaki
17. Valbona Isa Bujaki
18. Sonila Isa Bujaki
19. Servete Zenel (Zejnol) Rade (Bujaki)
20. Ajten Zydi Rade
21. Ndoc Gjelosh Vata
22. Bajram Sulejman Kapidani

23. Merita Xhemal Kapidani
24. Loris Bajram Kapidani
25. Andi Bajram Kapidani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr.3023, datë 21.5.2001

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J :

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Saimir Avni Leksani
2. Edlira Nazmi Jakupi
3. Mihal Andon Pema
4. Natasha Dim Pema (Bombaj)
5. Ariton Mihal Pema
6. Julian Mihal Pema
7. Artur Qemal Berami
8. Dorina Andon Berxholi
9. Shuaip Sadik Alushi
10. Xhensilda Shuaip Alushi
11. Arnold Shuaip Alushi
12. Spartak Bashkim Musha
13. Thea Spartak Musha
14. Suela Xhemal Musha (Çela)
15. Musa Islam Lami
16. Pranvera Feçor Lami (Shehu)
17. Helda Musa Lami
18. Zana Musa Lami
19. Eva Musa Lami
20. Agim Jashar Gabaj
21. Lumnije Xhevdet Gabaj (Hyka)
22. Edmond Kristofor Harito
23. Helena Spiro Harito (Kotoko)
24. Albina Edmond Harito

25. Adriatik Novruz Canaj
26. Anisa Adriatik Canaj
27. Armidio Iljaz Aliaj
28. Glen Armidio Aliaj
29. Fred Armidio Aliaj
30. Iliriana Osman Aliaj (Hoti)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 6.6.2001
Doli nga shtypi më 7.6.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 100 lekë